



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRISHTINE

Numri i lëndës: 2023:189026

Datë: 04.06.2024

Numri i dokumentit: 05780051

**PKR.nr.350/2023**

### NË EMËR TË POPULLIT

**GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË** - Departamenti për Krime të Rënda, Kryetari i trupit gjykues Gëzim Ademi, me anëtarët e trupit gjykues - gjyqtarët: Medie Bytyqi dhe Kushtrim Shyti, me pjesëmarrjen e bashkëpunëtorit profesional Albrim Kastrati, në çështjen penale kundër të pandehurit N.D., i akuzuar për veprën penale në bashkëkryerje Grabitje nga neni 317, paragrafi 3 lidhur me paragrafin 1 dhe lidhur me nenin 31 të KPRK-së dhe veprës penale Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 366, paragrafi 1 të KPRK-së, sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Prishtinë – Departamenti për Krime të Rënda PP/I.nr.196/2023 të datës 17.11.2023, pas mbajtjes dhe përfundimit të shqyrtimit gjyqësor me datën 02.05.2024, në prani të Prokurorit të Shtetit Dulina Hamiti, të pandehurit N.D. me mbrojtësen e tij sipas autorizimit av. Elena Dragusha dhe përfaqësuesit të palës së dëmtuar banka B., z. Ilir Ismajli, më datë 02.05.2024 mori dhe publikisht shpalli, ndërsa me datë 04.06.2024 përpiloi këtë:

### A K T G J Y K I M

Kundër të akuzuarit:

N.D., nga i ati B. dhe e nëna Sh., e vajzërisë Xh., i lindur me datë ... në P., me adresë të vendbanimit në rrugën “A.V.”, numër ..., lagja “K.” në P., me numër personal të ID-së ..., punon shitës ambulantiv, i martuar, ka të kryer fakultetin doganë dhe shpedicion, gjendja e mesme ekonomike, Shqiptar - Shtetas i Republikës së Kosovës.

## Ë S H T Ë F A J T O R

### I

Sepse:

Me datë 01.09.2023, rreth orës 13:39, në Sh. “N. T.” në P., konkretisht në filialin e bankës “B.”, i pandehuri N. D. në bashkëkryerje pas një marrëveshje paraprake me të pandehurin D.T. i cili gjendet në arrati, me qëllim që vetit ti sjellin përfitim pasuror të kundërligjshëm me përdorimin e forcës dhe kanosjes serioze duke vepruar me dashje dhe nën kërcënimin e armës nga i pandehuri D., kanë përvetësuar pasurinë e luajtshme të dëmtuarës bankës B. si dhe punonjësve të saj F. H., A. K., A. R., M. S., Sh. S., V. Q. dhe M. J. – klientë e bankës, duke ju thënë punonjëseve të bankës “mos lëvizni qitni paratë” të pandehurit kanë arrit të marrin shumën e parave në vlerë rreth trembëdhjetë mijë (13,000.00) Euro dhe kanë ikur nga vendi i ngjarjes, mirëpo nga i pandehuri N.D. ne vendin e ngjarjes pas arrestimit Policia kanë arritur që ti sekuestrojnë parat e grabitura ne vlere prej 5,810.00 Euro, e cila shumë e mjeteve i është kthyer palës së dëmtuar, me ç ‘rast të dëmtuarës B. bankë i kanë shkaktuar dëm material në vlerë prej 7,320.00 Euro.

Me këtë veprim në bashkëkryerje ka kryer veprën penale Grabitje nga neni 317 paragrafi 3 lidhur me paragrafin 1 lidhur me nenin 31 të KPRK-së.

Andaj, gjykata në bazë të neneve 4, 7, 8, 9, 10, 17, 21, 31, 38, 39, 40, 42, 43, 69, 70, 317 paragrafi 3 lidhur me paragrafin 1 të KPRK-së, si dhe në bazë të neneve 363, 364, 365, 366, 368, 450, 452,462 të KPPRK-së, të akuzuarin e:

## G J Y K O N

- I. Për veprën penale të përshkruar si në piken I te dispozitiv te këtij aktgjykimi, te pandehurit i cakton dënim me burgim në kohëzgjatje prej pesë (5) vite, i cili dënim do të ekzekutohet pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi dhe dënim me gjobe në shumen prej një mijë (1,000.00) Euro, i cili dënim do të ekzekutohet në afat prej 15 ditëve, pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.
- II. Nëse dënimi i shqiptuar me gjobe nuk do te paguhet ne afat prej 15 ditëve pas plotfuqishmërisë se këtij aktgjykimi, gjykata dënimin me gjobë në bazë të nenit 43 par. 3,

të KPRK-se, do ta zëvendësoj me dënim me burg, ku një (1) ditë burgim do të llogaritet me 20 (njëzet), euro gjobë.

- III.** Ne bazë të nenit 79 të KPPRK-së, të akuzuarit i llogaritet koha e kaluar ne paraburgim nga data 01.09.2023 deri ne plotfuqishmërinë e këtij aktgjykimi, por jo më gjatë se dënimi i shqiptuar.
- IV.** Të pandehurit i është vazhduar masa e paraburgimit nga data 02.05.2024, deri në plotfuqishmërinë e këtij aktgjykimi, por jo më shumë se dënimi i shqiptuar nga gjykata e shkallës së parë.
- V.** Obligohet i akuzuari t'i paguaj shpenzimet e procedurës gjyqësore sipas llogarisë përfundimtare të kësaj gjykate dhe atë; në emër të paushallit gjyqësor shumë prej njëqind (100) Euro dhe në emër të taksës për Fondin e Kompensimit të Viktimave të Krimit shumë prej pesëdhjetë (50) Euro, të gjitha këto në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcënimin e përmbarimit të dhunshëm.
- VI.** Pala e dëmtuar B. Bankë sipas adresës rruga "U. H." numër ..., P., për realizimin e kërkesës pasurore juridike, udhëzohet në kontest të rregullt civilo-juridik.

Ne mbështetje të nenit 363 paragrafi 1, pika 1.3 të KPPRK-se,

## **LIROHET NGA AKUZA**

### **II**

Sepse,

Me datë, kohë dhe vend të njëjtë si në dispozitivin e dytë të aktakuzës, i pandehuri në kundërshtim me ligjin e zbatueshëm për armë, pa autorizim ka mbajtur në pronësi, kontroll dhe ka poseduar armë zjarri, të cilën e ka përdorur si mjet i kryerjes së veprës penale.

Me këtë kishte për të kryer veprën penale Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 366 paragrafi 1 të KPRK-së.

Sepse nuk është provuar se i akuzuari ka kryer veprën penale për të cilën akuzohet.

## **A r s y e t i m**

### *Rrjedha e procedurës:*

Prokuroria Themelore në Prishtinë, ka ngritur aktakuzën me numër PP/I.nr.196/2023 të datës 17.11.2023, ndaj të pandehurit N.D., për shkak të veprës penale në bashkëkryerje Grabitje nga neni 317, paragrafi 3 lidhur me paragrafin 1 lidhur me nenin 31 të KPRK-së dhe veprës penale Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 366, paragrafi 1 të KPRK-së.

Pasi që i pandehuri nuk e ka pranuar fajësinë në seancën e shqyrtimit fillestar të datës 15.12.2023 për veprat penale sipas aktakuzës, të njëjtit konform dispozitave ligjore i është dhënë mundësia e paraqitjes së kundërshtimit të provave dhe kërkesës për hedhje të aktakuzës, për të cilin mbrojtësi të pandehurit ka paraqitur kundërshtimin e provave dhe kërkesën për hedhje të aktakuzës me datë 16.01.2024, ku Gjykata me Aktvendimin PKR.nr.350/2023 të datës 30.01.2024 e ka refuzuar si të pa bazuar kundërshtimin e provave dhe kërkesën për hedhje të aktakuzës. Pasi që ky aktvendim ka marrë formë të prerë, gjykata ka caktuar dhe mbajtur seancat e shqyrtimit gjyqësor të kësaj lënde, duke filluar me fjalën hyrëse të palëve, paraqitjen e provave dhe administrimin e tyre dhe fjalën përfundimtare.

### *Fjala përfundimtare:*

Prokurori i Shtetit në seancën e datës 02.05.2024, në fjalën përfundimtare ka deklaruar: Pas administrimit të provave dhe dëshmive dhe me dëgjimin e të dëmtuarve – dëshmitarëve, të cilët janë dëgjuar gjatë shqyrtimit gjyqësor dhe me administrimin e provave materiale, të cilat u administruan në shqyrtimin e sotëm gjyqësor, e po ashtu edhe vetë i pandehuri në mbrojtjen e tij e ka pranuar faktin se është kryes i veprës penale. Është vërtetuar në mënyrë të plotë se i pandehuri N.D., në bashkëkryerje me të pandehurin D. T. ka kryer veprën penale Grabitje nga neni 317, paragrafi 3 lidhur me paragrafin 1, e lidhur me nenin 31 të KPRK-së dhe vepra penale Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 366, paragrafi 1 të KPRK-së. Mbetet në tërësi pranë aktakuzës dhe i propozon gjykatës ta shpall fajtor të pandehurin N.D. dhe ta dënoj sipas ligjit dhe me rastin e matjes së dënimit të merren parasysh rrethanat rënduese siç janë: mënyra e kryerjes së veprës penale, pesha e veprës penale dhe pasoja e shkaktuar me kryerjen e veprës penale.

Përfaqësuesi i të dëmtuarës banka “B.”, I. S. në seancën e datës 02.05.2024 në fjalën përfundimtare ka deklaruar se mbështet në tërësi fjalën përfundimtare të prokurores dhe parashtron kërkesë pasurore – juridike. Pala e dëmtuar banka BKT me datë 15.12.2023 ka parashtruar në Gjykatë, Deklaratën për kërkesën pasurore juridike me të cilin i është shkaktuar dëmi në shumën prej, 7.320 Euro (shtatë mijë e treqind e njëzetë), pasi që mjetet monetare-parat e konfiskuara nga i pandehuri N.D. i janë kthyer palës së dëmtuar B. Pra diferenca e dëmit është si në kërkesën pasurore juridike, të cilën shumë të mjeteve janë të grabitura nga i pandehuri tjetër D. T. Andaj dëmi i shkaktuar nga i pandehuri N.D. i është kthyer bankës ndërsa pjesa e tjetër e dëmit është i shkaktuar nga i pandehuri D. T.

Mbrojtësja e të akuzuarit në seancën e datës 02.05.2024, në fjalën përfundimtare ka deklaruar se prokuroria nuk ka mundur aspak të vërtetojë gjendjen faktike të përshkruar si në aktakuzë, e aq më pak të vërtetojë dhe arsyetojë kualifikimin ligjor për veprën penale për të cilën akuzohet. Ne e kundërshtojmë gjendjen faktike të përshkruar si në aktakuzë për të akuzuarin N.D., për shkak se nuk ka asnjë provë materiale apo formale, që e vërtetojnë gjendjen faktike të përshkruar në aktakuzë. Këtë e arsyetojmë në këtë mënyrë; duke filluar nga dëshmitë e dëshmitarëve në seancat e kaluara, duke e arsyetuar në video incizimin e seancës së sotme, ku i mbrojturi im nuk ka bërë asnjë veprim për të lënduar punonjësit e bankës dhe shihet qartë se nuk ka qenë fare i armatosur.

Konsiderojmë se prokuroria nuk ka mundur ta arsyetojë kualifikimin ligjor, për të cilin N.D. akuzohet, pasi që nuk janë përmbushur elementet e kësaj vepre penale dhe nga vetë deklarimi i Nazmiut në këtë seancë, pendimi i tij, dijenia, dashja, përfitimi material nga kryerja e kësaj vepre penale, vënia në qarkullim i mjeteve të marra nga banka, ku e kemi se të gjitha mjetet janë kthyer palës së dëmtuar, dëshmitarët dhe të dëmtuarit në seancën e kaluar nuk e ndjekin penalisht të mbrojturin tim. Andaj, duke marr parasysh të gjitha këto, dijeninë, dashjen dhe përfitimin material, gjykatës i propozoj të merr aktgjykim lirues sa i përket veprës penale si në pikën II të aktakuzës: Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 366, paragrafi 1 të KPRK-së, ndërsa të merr aktgjykim dënues sa i përket pikës I të dispozitivit të aktakuzës që ka të bëjë me veprën penale Grabitje nga neni 317, paragrafi 3 lidhur me paragrafin 1, e lidhur me nenin 31 të KPRK-së. I propozoj gjykatës që në raport me këtë vepër penale të bëhet rikualifikimi, ashtu që të hiqet paragrafi 3 dhe të mbetet paragrafi 1 i këtij neni, ngase konsideroj se i mbrojturi im nuk ka pasur armë. Me rastin e matjes së lartësisë së dënimit, gjykata të merr parasysh rrethanat lehtësuese siç janë: dijenia, dashja, pendimi i thellë i të mbrojturit tim, bashkëpunimi i tij në të gjitha seancat, sinqeriteti i tij dhe mosha e tij. Meqenëse kanë pushuar

të gjitha arsyet ligjore për të cilat është vazhduar masa e paraburgimit, duke pasur për bazë edhe kohën e qëndrimit aq të gjatë në paraburgim, i propozoj gjykatës që të mbrojturit tim t'i ndërpritet paraburgimi me një aktvendim të veçantë dhe t'i zëvendësohet me masën e arrestit shtëpiak ose lajmërimin në polici. Gjithashtu, i premtojmë gjykatës se do ta mbajmë premtimin në përpikëri.

I akuzuari në seancën e datës 02.05.2024, në fjalën përfundimtare ka deklaruar se: E mbështes në tërësi fjalën përfundimtare të mbrojtëses time dhe i kërkon gjykatës ta ndërpres masën e paraburgimit, të më shqiptohet një dënim sa më i ulët, duke pasur parasysh moshën që e kam dhe të vazhdoj një jetë normale jashtë.

*Provat e administruara:*

Në shqyrtimin gjyqësor publik, gjykata konform nenit 7 të KPPRK-së, saktësisht dhe në mënyrë të plotë vërtetoi faktet që janë të rëndësishme për marrje të vendimit të ligjshëm, me vëmendje dhe përkushtim maksimal profesional dhe përkujdesje të njëjtë vërtetoi faktet kundër të akuzuarit, si dhe ato në favor të tij, duke i mundësuar të akuzuarit shfrytëzimin e të gjitha fakteve dhe provave që janë në favor të mbrojtjes dhe me ndërgjegje vlerësoi çdo provë një nga një dhe në lidhje me provat tjera, gjithashtu gjykata për vërtetimin e gjendjes faktike lidhur me këtë çështje penale juridike, në kuptim të dispozitave të nenit 7 dhe nenit 360 të KPPRK-së, ka dëgjuar dëshmitarët, F. H., M. J., M. S., A. R., A. K., Sh. S. dhe V. Q., si dhe është dëgjuar në cilësinë e dëshmitarit përfaqësuesja e bankës B. z. A. B., si dhe ka administruar provat materiale: Raporti i këqyrjes së vendit të ngjarjes nga Njësia e Forenzikës e datës 01.09.2023 me numër të rastit 2023-AB-2326; Lista e dëshmimeve nga Njësia e Forenzikës e datës 01.09.2023 me numër të rastit 2023-AB-2326; Vërtetimi mbi sekuestrimin e përkohshëm të sendeve i datës 01.09.2023 me numër të rastit 2023-AB-2326; Vërtetimi mbi kthimin e sendeve i datës 01.09.2023 me numër të rastit 2023-AB-2326, si dhe Foto dokumentacioni në shkresat e lëndës, si dhe shkresat tjera të lëndës; Raportet e bankës "B." të datës 01.09.2023 dhe një CD, ashtu që Gjykata mbi bazën e këtyre provave, pas vlerësimit të tyre ka vërtetuar gjendjen faktike si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

*Deklarimet e dëshmitarëve:*

Lidhur me këtë çështje penalo-juridike, me qëllim të vërtetimit të drejtë dhe të plotë të gjendjes faktike, gjykata ka dëgjuar të dëmtuarit në cilësinë e dëshmitarëve të propozuar nga Prokuroria e Shtetit, dëshmitarët F. H., M. J., M. S., A. R., A. K., Sh. S. dhe V. Q si dhe është dëgjuar në cilësinë e dëshmitarit përfaqësuesja e bankës B. z. A. B.

E dëmtuara F. H., e dëgjuar ne cilësi te dëshmitares, në seancën e shqyrtimit gjyqësore të datës 16.04.2024, ka deklaruar se: Atë ditë, kam qenë në bankën “B.” dhe i qëndroj në tërësi deklaratës të dhënë në polici më datë 01.09.2023. Atë ditë, rreth orës:13:00, ditë e premte, kam qenë në vendin e punës si arkëtarë në sportelin e dytë tek hyrja, ka ardhur i pandehuri N.D. para meje, i ka qit duart në llastik me qese në dorë dhe ka bërtit me një zë shumë të lartë: “Qiti paratë”, unë kam qenë shumë e traumatizuar dhe kam vepruar ashtu siç më ka thënë grabitësi dhe në atë rast ia kam gjuajtur paratë në qese dhe i njëjti ka dal jashtë. I pandehuri N.D., ditën kritike nuk ka pasur armë, ka pasur maskë mjekësore të Covidit, ngjyrë të kaltër të çelët, i ka marr paratë dhe ka ikur. Unë e kam parë vetëm të pandehurin N.D., ndërsa kam dëgjuar zhurma se ka qenë prezent edhe një grabitës tjetër tek sporteli i parë, ku ka qenë V. Q. Pasi i kam dorëzuar paratë të pandehurit, jemi larguar nga arkat dhe kemi shkuar bashkë me koleget në një zyre tjetër dhe e kemi qetësuar njëra – tjetrën, pastaj kanë ardhur policia menjëherë dhe e kanë zënë në flagrancë grabitësin. Paratë që më janë marrë nga arka ime, më janë kthyer përsëri nga Policia, pasi e kanë kapur në flagrancë të pandehurin dhe nga i kanë marrë të njëjtat. Në sportelin tjetër, grabitësi tjetër e ka marr një shumë tjetër të parave dhe ajo shumë nuk është kthyer.

E dëmtuara M. J., e dëgjuar ne cilësi te dëshmitares, në seancën e shqyrtimit gjyqësor te datës 16.04.2024, ka deklaruar se: Ditën kritike kam qenë në bankë si kliente, kam qenë në sportelin e parë për të bërë tërheqjen e parave dhe derisa isha duke i dhënë të dhënat tek punëtorja e bankës, kam dëgjuar kur kanë hyrë persona në bankë dhe kanë filluar të bërtasin: “Paratë dhe mos lëvizni”, mbetem pranë deklaratës të dhënë në Polici. Unë në ato momente nuk i kam marr shumë seriozisht grabitësit, është afruar njëri person tek sporteli ku kam qenë unë dhe i ka kërkuar paratë, unë i kam thënë të mos i merr paratë. Tani nuk e mbaj mend dhe nuk e di cili nga ata persona ka qenë, sepse nuk e kam shikuar në fytyrë. Arkëtarja ia ka dhënë paratë në tavolinë, grabitësi i mori paratë dhe ka ikur nga vendi i ngjarjes, e ka pasur një kapele dhe një maskë mbrojtëse të virusit Covid. Unë i kam shkuar mbrapa grabitësit, kam vrapuar pas tij dhe i kam thënë të ndalet, mirëpo nuk më kujtohet personi në sallë a është ky, sepse nuk e mbaj në mend fytyrën e tij. Unë e kam ndjekur pas përafërsisht diku rreth 300 metra. Para se të hyj në bankë, unë e kam parë që kanë qenë disa policë aty dhe kur kam dal ta ndjek grabitësin, i kam thirr edhe policinë. Me atë rast, policia e ka zënë grabitësin, por nuk e di nëse është ky i njëjti në sallë, nuk kam mundur ta vërej nëse kanë pasur armë apo jo, mirëpo personi që e kam pasur afër nuk ka pasur armë. Të pandehurit nuk kanë qenë me maska, nuk kam mundur t’i identifikoj dhe të njëjtit nuk i njoh. Personi që ka qenë afër meje, ka qenë me kapele në kokë, me gjatësi mesatare dhe

pak i plotë. Në momentin kur policia e kanë arrestuar të pandehurin, unë kam qenë në afërsi 1 metër dhe nuk i kanë konfiskuar policia armë të arrestuarit, paratë ia kanë konfiskuar. Punëtorët në sportelin e bankës kanë qenë shumë të shqetësuar, ngase kur kanë hyrë grabitësit, kanë thënë të mos lëvizin dhe t'i qesin paratë dhe arkëtarja i ka qit paratë.

E dëmtuara M. S., e dëgjuar në cilësi të dëshmitares, në seancën e shqyrtimit gjyqësor të datës 16.04.2024, ka deklaruar se: Unë kam qenë në bankë në momentin e grabitjes afër koleges time Sh. S., e cila ka qenë analiste kreditore, i kam parë grabitësit, kanë qenë dy persona, kanë filluar të bërtasin: “Paratë”, D. ka pasur armë me vete, i cili na ka drejtuar armën, ka kërkuar paratë, iu ka drejtuar sportelit tek V., ku ka kërkuar paratë, e njëjta ia ka qit paratë në tavolinë, nuk e di a ka pasur qese në dorë, D. i ka kapur paratë dhe ka ikur nga vendi i ngjarjes, ka pasur maske të Covidit, kapele ka pasur me sa më kujtohet. N.D. ka qenë së bashku me D., nuk ka pasur maskë dhe as kapele, armë nuk ka pasur. Kemi qenë shumë të shqetësuar në ato momente, ngase D. ka pasur armë, nuk më kujtohet çfarë arme ka qenë. Personi që ka repetit armën ka qenë larg meje rreth 7 metra.

I dëmtuari A. R., në cilësinë e dëshmitarit, në seancën shqyrtim gjyqësor të datës 16.04.2024, ka deklaruar se: atë ditë isha duke punuar në bankë, kam qenë prezent kur ka ndodhur grabitja, i kam parë grabitësit kur kanë hyrë në bankë, kanë qenë dy persona, kur kanë hyrë në derë kanë bërtitur “Grabitje”, armën e ka repetitur njëri nga grabitësit, i cili nuk është prezent këtu në sallë, nuk është i pandehuri N.D., por është personi tjetër. Kanë bërtitur t'i qesin paratë, unë vetëm i kam dëgjuar kur kanë thënë t'i qesin paratë, por unë nuk i kam parë, sepse në vendin ku kam qenë unë, nuk kanë qenë të dukshme sportelet. Në ato momente kam qenë i shqetësuar. Nuk më kujtohet çfarë arme ka qenë, ngjyra ka qenë e mbyllur, por nuk më kujtohet saktë, arma ka qenë e shkurtër dhe atë e ka poseduar personi i parë që ka hyrë në bankë, e që të njëjtin nuk e njoh, i njëjti ka qenë me maskë medicinale të Covidit, ka pasur kapele në kokë, ka qenë gjatë, i dobët e që dallon nga i pandehuri këtu në sallë.

I dëmtuari A. K., në cilësinë e dëshmitarit, në seancën shqyrtim gjyqësor të datës 16.04.2024, ka deklaruar se: atë ditë isha në bankë duke kryer pagesë dhe përderisa kam qenë tek arka dhe punëtorja aty më thotë se duhet të shkoj në një sportel tjetër dhe gjatë atij momenti futen dy persona brenda në bankë, duke na kërkuar t'i lirojmë arkat, po shikoj prapa dhe i kam parë dy persona dhe kam vazhduar në anën e majtë tek sporteli tjetër, duke ia liruar hapësirat, ashtu siç kanë kërkuar. Grabitësit kanë bërtitur punëtorëve në arkë “Qitni paratë”, unë tërë kohën nuk i



kam parë grabitësit, mirëpo atë çfarë kam parë është se kanë kërkuar para nga punëtorët e bankës, të njëjtat nuk i kam parë duke ia dhënë paratë, ngase pozita e imja ka qenë mbrapa personave dhe nuk kam mundur ta shoh duke ia dhënë paratë. Armë tek grabitësit nuk kam parë, të njëjtit kanë pas maskë të Covidit, njëri nga ta ka qenë me qese në dorë, duke kërkuar nga punëtorja t'i fus paratë në qese. Unë i kam parë grabitësit jashtë bankës, duke vrapuar dhe më tutje nuk e di.

E dëmtuara Sh. S., e dëgjuar ne cilësi të dëshmitares, në seancën e shqyrtimit gjyqësor të datës 16.04.2024, ka deklaruar se: ditën kritike, kur ka ndodhur grabitja unë kam qenë në bankë, jam analiste kreditore, kanë hyrë dy persona në bankë, kanë bërë titur "Qitni paratë shpejtë, të trasha", personi N.D. nuk ka pasur armë, mirëpo i njëjti e ka pasur vetëm një qese me vete dhe ka shkuar tek sporteli i arkës, ku ka qenë duke punuar F.H. dhe ia ka marr paratë ndërsa personi tjetër, të cilit emrin nuk ia di, ka pasur armë me vete, me sa më kujtohet ka qenë e zezë, është afruar tek arka tjetër tek kolegja V. Q. Të dy grabitësit i kanë marr paratë, kanë dal nga banka, duke u shtyrë me klienten e cila ka qenë tek arkëtarja, policia e cila ka qëlluar afër e ka zënë. Të dy të pandehurit kanë pasur maska të Covidit, të dy kanë pasur kapele në kokë, ne kemi qenë shumë të shqetësuara në ato momente, por kam arritur ta prek panik butonin, të cilin posa ta shtypim, lajmërohet policia automatikisht me alarm dhe përmes tij policia e kupton nga cila bankë është ndezur alarmi.

E dëmtuara V. Q., e dëgjuar ne cilësi të dëshmitares, në seancën e shqyrtimit gjyqësor të datës 16.04.2024, ka deklaruar se: Po, kam punuar në bankën "B." në pozitën arkëtare, i kam parë të pandehurit kur kanë hyrë brenda në bankë, të njëjtit kanë bërë titur: "Shpejtë, qitni paratë, të trasha, të trasha", janë afruar tek sporteli, unë kam qenë arkëtare, grabitësi tjetër, e jo ky në sallë është afruar tek sporteli im, ka kërkuar paratë, ia kam dorëzuar paratë, armën e ka pasur ky grabitës, ia kam dorëzuar shumën në vlerën prej 7,000 €, i njëjti ka pasur armë mbrojtëse të Covidit, i ka marr paratë dhe ka dal nga banka, gjatë kohës sa m'i ka marr paratë, armën e ka pasur të drejtuar nga unë. Njëkohësisht, gjatë kohës së grabitjes ka diskutuar me klienten e cila ka qenë tek unë, e cila klientë pas grabitjes i ka shkuar mbrapa grabitësit. Derisa grabitësi më thoshte "Paratë, paratë", klientja ia kthente përgjigjen: "Çfarë para?", pastaj kanë dal jashtë dhe kanë ikur, pastaj kam dëgjuar se njërin nga grabitësin e kanë zënë policia dhe ia kanë marrë paratë, armë nuk i kanë gjetur. Nuk më kujtohen veprimet e grabitësit N.D. dhe armë nuk ka pasur. Në ato momente, jemi frikësuar shumë. Paratë janë kthyer nga i pandehuri N. por nuk janë kthyer nga i pandehuri tjetër i cili më ka grabitur mua.

Më datë 16.04.2024, në seancën e shqyrtimit gjyqësor në cilësinë e dëshmitarit është dëgjuar përfaqësuesi i bankës B. znj. A. B., e cila ka deklaruar: se në bankën B. kam pozitën e juristes, në ditën kritike nuk kam qenë në bankë andaj nuk e kam parë askënd duke vjedhur, për pjesën e dëmit të shkaktuar ndaj të dëmtuarës bankës B. është rreth 7,320.00 Euro por pas konsultimit me organet e bankës do të deponojmë shkresën zyrtare ku edhe do të paraqesim kërkesën pasurore juridike.

Pas dëgjimit dhe administrimit të provave personale të dëmtuarve në cilësinë e dëshmitarëve, gjykata ka vazhduar me administrimin e provave materiale si: Raporti i këqyrjes së vendit të ngjarjes nga Njësia e Forenzikës e datës 01.09.2023 me numër të rastit 2023-AB-2326; Lista e dëshmive nga Njësia e Forenzikës e datës 01.09.2023 me numër të rastit 2023-AB-2326; Vërtetimi mbi sekuestrimin e përkohshëm të sendeve i datës 01.09.2023 me numër të rastit 2023-AB-2326; Vërtetimi mbi kthimin e sendeve i datës 01.09.2023 me numër të rastit 2023-AB-2326, si dhe Foto dokumentacioni në shkresat e lëndës, si dhe shkresat tjera të lëndës; Raportet e bankës “B.” të datës 01.09.2023 dhe një CD.

Nga raporti i këqyrjes së vendit të ngjarjes të punuar nga Njësia e Forenzikës me numër të dosjes së forenzikës 23-190VN dhe dosjes së hetimeve 2023-AB-2326 të datës 01.09.2023, në ora 13:40 është konstatuar se me datë 01.09.2023 në 13:40 në filialen e bankës B., që gjendet në Sh. “N. T.” në Prishtinë ka ndodhur rasti i Grabitjes, ku ekipet e Teknikës së Kriminalistikës Rajonale në Prishtinë kanë dalë në vend të ngjarjes. Me të arritur në vend ngjarje është konstatuar se ka ndodhur një rast grabitje nga dy persona nga të cilët njëri kishte pas armë zjarri dhe tjetri me qese të “V. F.”, ku njëri nga persona ka kanosur zyrtaren e bankës tek arka dhe ka marrë para në vlerë rreth 6,750.00 Euro, kurse i dyshuari tjetër nga zyrtarja tjetër në arkë ka marrë para në vlerë rreth 5,800.00 Euro. Në reagim të shpejt nga zyrtaret policor që ishin gjendur aty afër kanë arritur që të arrestojnë të dyshuarin N.D. së bashku me shumën e parave që kishte grabitur. Vendi i ngjarjes në bankë është fotografuar, si dhe është fotografuar një objekt banesor në afërsi të bankës ku janë evidentuar dëshmi lidhur me rastin.

Nga lista e dëshmive të Njesisë Forenzikës të datës 01.09.2023 me numër të rastit 2023-AB-2326, janë fotografuar dhe evidentuar dëshmi lidhur me ngjarjen, e që sipas listës janë: VN#1- dera e hyrjes kryesore të bankës B., në Sh. “N. T.”, VN#2- tavolina e punës dhe arka në të majtë ku ishte duke punuar arkëtarja V. Q. nga e cila ishte grabitur shuma e parave në vlerë 6,750.00 Euro, VN#3 - tavolina e punës dhe arka në të majtë që ishte në afërsi me arkën tjetër, ku ishte

duke punuar arkëtarja F. H., nga i cila ishte grabitur shuma e parave në vlerë 5,800.00 Euro, VN#4- hyrja e pasme e objektit banesor ku ishin gjetur dëshmi lidhur me ngjarjen, VN#5 është evidentuar një maskë Covid, ngjyrë e kaltër në dysheme të korridorit të katit përdhese, VN#6- është evidentuar një kapelë bejsbolli ngjyrë krem, e gjetur po ashtu në dysheme të korridorit të katit përdhese, VN#7- është evidentuar një maskë Covid, ngjyrë e kaltër e gjetur në korridor në anën e majtë të derës hyrëse të objektit banesor, VN#8- është evidentuar një kapelë bejsbolli ngjyrë e zezë e gjetur në korridor në anën e majtë afër derës së hyrjes së objektit banesor, VN#9- është evidentuar hyrja kryesore e objektit banesor tek Sh. “N. T.”. Pjesë e listës së dëshmive është edhe raporti plotësues nga Njësia Forenzike të datës 01.09.2023 në ora 18:00, ku me vullnetin e lirë i pandehuri N.D. ka pranuar të jap mostrat e pështymës për ADN pas kërkesës nga zyrtari hetues së Policisë dhe atë një tampon i sterilizuar është marrë mostra e pështymës për ADN nga ana e djathtë e zgavrës së gojës së të dyshuarit N.D. dhe një tampon i sterilizuar është marrë mostra e pështymës për ADN nga ana e majtë e zgavrës së gojës së të dyshuarit N.D.. Po ashtu, në listën e dëshmive janë fotografitë e realizuara nga vendi i ngjarjes që gjenden në shkresë të lëndës.

Nga Vërtetimi mbi sekuestrimin e përkohshëm të sendeve i datës 01.09.2023 me numër të rastit 2023-AB-2326, është konstatuar se me datë 01.09.2023 nga zyrtari policor A.R. PK#... janë sekuestruar përkohësisht mjetet monetare nga i dyshuari N.D. i lindur me datë ... me numër personal ..., i cili ishte kapur në flagrancë nga Policia pas kryerjes së Grabitjes në bankën B.

Nga Vërtetimi mbi kthimin e sendeve të sekuestruara përkohësisht të sendeve i datës 01.09.2023 me numër të rastit 2023-AB-2326, është konstatuar se me datë 01.09.2023 nga zyrtari policor A.R. PK#. janë kthyer mjetet monetare tek personi A. Zh. (menaxher i degës së bankës B. tek Sh. “N. T., ku kishte ndodhur ngjarja) i lindur me datë ... me numër personal ..., sasia e mjeteve të kthyera ishte në shumën prej 5,810.00 Euro.

Nga prova materiale raportet e bankës është konstatuar diferenca e mjeteve monetare nga arkat e bankës të cilat janë ekzaminuar pas kryerjes së veprës penale nga Grabitësit, këto raporte kanë treguar se në arkën e arkëtares V. Q. ka diferencë të mjeteve monetare në shumën prej, 6,570.00 Euro ndërsa tek arka e arkëtares F. H. kishte diferencë monetare në shumën prej 5.810.00 Euro. Nga prova materiale CD video incizimet e marra nga brendësia e bankës B., shihet ngjarja e zhvilluar brenda në bankë, aty shihet i pandehuri N.D., i cili ka shkuar tek arka me një qese të najlonit në dorë, i cili e ka hapur qesen, duke i kërkuar paratë dhe të njëjtit i dorëzohen paratë nga punëtorja – arkëtarja e bankës, pastaj i merr paratë dhe del nga banka, në kamerën 03, minuta

2:44 në hyrje të bankës shihet i pandehuri i cili me dy duar e mban qesen e najlonit, duke shkuar tek arkëtarja, e po ashtu aty shihet edhe i pandehuri D. T., i cili shihet me armë në dorë. Në minutën 3:20 shihet e dëmtuara – dëshmitarja M. J., duke i ndjekur të pandehurit, pasi që të njëjtit i kanë marr paratë.

*Mbrojtja e te pandehurit:*

I pandehuri N.D., në mbrojtjen e tij te dhënë ne shqyrtimin gjyqësor dt. 02.05.2024, ka deklaruar se: atë ditë një orë më herët jemi takuar me D., kemi pirë birr dhe kemi konsumuar substancë narkotike, në ditën kritike të grabitjes unë nuk kam pas armë por ka pasur D., me D. njihemi që një kohë. Në takim me D., jam ankuar për shpenzimet që ka bashkëshortja për të pasur fëmijë, pasi që disa herë ka dështuar, D. më tha: “A e kryejmë një punë të lehtë?, Shkojmë hyjmë në bankë, me grabit”, e kështu do të shliroheshim financiarisht. Unë i kam thënë: “Unë asnjëherë nuk kam kryer këto vepra penale, as hajni e asgjë tjetër”. Pastaj, më ka thënë se e ka një armë me gaz, e cila nuk hetohet, hyjmë na bankë, i marrim paratë dhe dalim për një minutë. Në atë rast, nën ndikim të substancave narkotike dhe alkoolit, unë jam dakorduar, e kemi blerë nga një kapele, maskë të Covidit, ai ka hyrë i pari, unë pas tij dhe i kam përcjell veprimet e tij. Unë ndihem shumë i turpëruar sot para gjykatës që e kam kryer këtë vepër penale, pasi që asnjëherë nuk kam kryer vepër përpara. Ne kemi hyrë në bankë, tek sporteli, tek arkëtarja, D. ka shkuar tek arkëtarja tjetër, i kam zgjatur duart, qesen e kisha në dorë dhe i kam kërkuar paratë nga e njëjta. Arkëtarja m’i ka gjuajtur paratë në qese, e kam kapur qesen dhe kam dal nga banka. Kur kam dal nga banka, e dëmtuara – dëshmitarja M. J.m’u ka vërsulur mbrapa, i ka thirr disa policë që kanë qëlluar aty afër, unë jam arrestuar rreth 200 metra afër bankës, duke më ndjekur ajo nga pas, ne kemi hasur patrullën e policisë, të njëjtit më kanë arrestuar, më kanë kontrolluar dhe më kanë marr shumën e parave që kam marr në bankë. Përveç parave, nuk më kanë gjetur policia asgjë tjetër, më kanë dërguar në stacionin policor, policët kanë deklaruar se me rastin e arrestimit, unë nuk kam pasur armë me vete. Kur ka ardhur hetuesi – polici A. për të më marr tek stacioni në lagjen e “Muhaxherëve”, polici që më ka arrestuar iu ka treguar në stacion që nuk ka pasur armë me vete, ua ka dorëzuar qesen e parave në stacion dhe një paketë cigare. Para se të hyj në bankë për grabitje, kam pasur në xhep një paketë cigare dhe një shkrepëz dhe qesen e najlonit në dorë, skam pas as kuletë, e as telefon.

*Vlerësimi i gjykatës për pikën I, vepra penale Grabitje:*

Gjykata, pasi dëgjoi dëshmitarët në këtë rast, administroi provat materiale, pretendimet e palëve, duke vlerësuar çdo provë një nga një dhe në lidhje me provat e tjera, në kuptim të nenit 360, par. 2, të KPP-së, arriti të vërtetojë se i akuzuari ka kryer veprën penale si në pikën I të aktakuzës.

Nuk është kontestues fakti se në bankën B. me datë 01.09.2023 rreth orës 13:39 në Sh. “N. T.” në Prishtinë ishte kryer Grabitja.

Nuk është kontestuese fakti se kryerës i veprës penale të Grabitjes ishte i pandehuri N.D. në bankën B. me datë 01.09.2023, po ashtu nuk ishte kontestuese se tek i pandehuri pas arrestimit dhe kontrollimit të tij, i janë gjetur dhe sekuestruar mjetet monetare-paret të cilat sapo kishe grabitur në bankë.

Nuk është kontestuese po ashtu fakti se mjetet monetare të sekuestruar, janë kthyer palës së dëmtuar po të njëjtin ditë nga Policia.

Nuk është kontestuese po ashtu fakti se tek i pandehuri pasi që ishte arrestuar nga Policia nuk i është gjetur asgjë tjetër përveç mjeteve monetare-parat e grabitura.

Nuk është kontestuese fakti se dëshmitaret e dëgjuar ishin punëtor të kësaj banke.

Për palët, gjendja faktike si më lartë nuk ka qenë kontestuese. Përveç kësaj, faktet si më lartë vërtetohen edhe nga provat e administruara gjatë shqyrtimit gjyqësor. Kjo gjendje faktike vërtetohet edhe nga vet i pandehuri.

*Gjendja faktike dhe vlerësimi i provave:*

Gjykata në kuptim të nenit 360 paragrafi 2 të KPPRK-së, me ndërgjegje ka administruar dhe vlerësuar secilën provë veç e veç dhe të gjitha në lidhshmëri njëra me tjetrën, ka vërtetuar përtej dyshimit të bazuar mirë se i pandehuri N.D. me datë 01.09.2023, rreth orës 13:39, në Sh. “N. T.” në Prishtinë, konkretisht në filialin e bankës “B.”, në bashkëkryerje pas një marrëveshje paraprake me të pandehurin D. T. i cili gjendet në arrati, me qëllim që vetit t’i sjell përfitim pasuror të kundërligjshëm, duke vepruar me dashje ka përvetësuar pasurinë e luajtshme të dëmtuarës bankës B. si dhe punonjësve të saj F. H., A. K., A. R., M. S., Sh. S., V.Q. dhe M. J. –

klitentë e bankës, duke ju thënë punonjëseve të bankës “mos lëvizni qitni paratë” i pandehuri ka arrit të marr shumën e parave në vlerë prej 5,810.00 Euro dhe ka ikur nga vendi i ngjarjes, me ç ‘rast të dëmtuarës bankës B. i ka shkaktuar dëm material. Këtë gjendje faktike, gjykata e ka vërtetuar nga provat që ka administruar në shqyrtim gjyqësor si: nga dëshmia e dëshmitares F. e cila ka deklaruar se ditën kritike ka ardhur i pandehuri N.D. para meje, i ka qit duart në llastik me qese në dorë dhe ka bërtit me një zë shumë të lartë: “Qiti paratë” dhe ashtu kam vepruar nuk ka pasur armë, ka pasur maskë mjekësore, ngjyrë të kaltër të çelët, maskë mbrojtëse nga Covidi, i ka marr paratë dhe ka ikur, të njëjtin fakt e thotë edhe dëshmitarja M. se i pandehuri N. ka qenë së bashku me të pandehurin tjetër D. të cilit kanë qenë në bankë për të grabitur, po ashtu dëshmitari A. deklaroi se i pandehuri N. ka qenë personi, i cili së bashku me të pandehurin tjetër D. kishin grabitur bankën atë ditë, po ashtu dëshmitarja Sh. deklaroi se atë ditë derisa ka qenë duke punuar në bankë kanë hyrë dy persona për të grabitur me armë ku njëri nga ta është i pandehuri N. për të cilin deklaroi se nuk ka pas armë por ka pas vetëm qesen dhe ka shkuar tek arka ku ishte duke punuar arkëtarja F. dhe sapo ka marr paratë është larguar nga banka. Fakt tjetër se ishte personi N.D. i cili ka kryer veprën penale të Grabitjes në bankën B. në ditën kritike vërtetohet edhe me dëshminë e dëshmitares M. J., e cila ka deklaruar se atë ditë ishte në bankën B. për të kryer shërbime bankare dhe për një moment kanë hyrë persona në bankë dhe kanë filluar të bërtasin: “Paratë dhe mos lëvizni”, ku njëri nga ata është ofruar tek sporteli ku isha unë duke kryer shërbimin, pasi ka marr paratë dhe është larguar, unë e kam ndjekur rreth 300 metra dhe aty kanë qëlluar Policia të cilin e kanë arrestuar.

Gjykata ka vlerësuar këto dëshmi të dëshmitareve si reale, të bazuara, koherente dhe objektive sepse secila nga dëshmitaret pohojnë faktin se ditën kritike në bankën B. kanë qenë dy persona, ku njëri nga ata persona ishte i pandehuri N.D. e për të cilin deklarojnë se nuk ka pasur armë, vetëm qesen e najlonit për të vendosur paratë ndërsa për të pandehurin tjetër deklarojnë se kishte pasur armë duke ju drejtuar personelit të bankës, andaj Gjykata këtyre dëshmimeve ju ka falur besimin si prova personale në të cilin dhe e bazon aktgjykimin.

Pas kryerjes së veprës penale të Grabitjes i pandehuri N.D. ishte larguar nga banka dhe pas pak ishte ndaluar dhe arrestuar nga Policia sepse dëshmitarja M. ishte vënë pas në ndjekje dhe sapo shef Policinë i njofton dhe arrestojnë të pandehurin N., nga i cili janë sekuestruar paratë e marra në bankë në shumën prej 5,810.00 Euro, e që ky fakt vërtetohet me provën materiale me Vërtetimin mbi sekuestrimin e përkohshëm të sendit i datës 01.09.2023 me numër të rastit 2023-AB-2326, ku zyrtari policor kishte sekuestruar mjetet monetare nga i pandehuri N.D., ndërsa nga

prova materiale Vërtetimi mbi kthimin e sendeve të sekuestruara përkohësisht të sendeve i datës 01.09.2023 me numër të rastit 2023-AB-2326, është vërtetuar se me datë 01.09.2023 nga zyrtari policor A. R. PK#... janë kthyer mjetet monetare tek personi A. Zh. (menaxher i degës së bankës B. tek Sh. “N. T.”, ku kishte ndodhur ngjarja), sasia e mjeteve të kthyera ishte në shumën prej 5,810.00 Euro.

Se ishte i pandehuri N.D. personi që kishte vepruar së bashku me personin tjetër D., vërtetohet edhe nga raporti i vendit të ngjarjes të datës 01.09.2023 me numër të dosjes së hetimeve 2023-AB-2326, listës se dëshmimeve dhe foto dokumentacionit, ku janë evidentuar dhe fotografuar dëshmitë e gjetura në vendin e ngjarjes si dëshmitë VN#2- tavolina e punës dhe arka në të majtë, ku ishte duke punuar arkëtarja V.Q., nga e cila ishte grabitur shuma e pareve në vlerë 6,750.00 Euro nga personi D. T., VN#3- tavolina e punës dhe arka në të majtë që ishte në afërsi me arkën tjetër, ku ishte duke punuar arkëtarja F. H. nga i cila ishte grabitur shuma e pareve në vlerë 5,800.00 Euro që ishte grabitur nga i pandehuri N.D., VN#5- është evidentuar një maskë Covid, ngjyrë e kaltër në dysheme të korridorit të katit përdhese, VN#6- është evidentuar një kapelë bejsbolli ngjyrë krem, e gjetur po ashtu në dysheme të korridorit të katit përdhese, VN#7- është evidentuar një maskë Covid, ngjyrë e kaltër e gjetur në korridor në anën e majtë të derës hyrëse të objektit banesor, VN#8- është evidentuar një kapelë bejsbolli ngjyrë e zezë e gjetur në korridor në anën e majtë afër derës së hyrjes së objektit banesor, dëshmitë si maskat Covid dhe kapelat të cilat ishin përdorur nga i pandehuri N. dhe personi tjetër D. me rastin e kryerjes së veprës penale të grabitjes në bankën B.

Gjykata nga prova materiale e administruar në shqyrtim gjyqësor, video incizimet në CD të cilat ishin marr nga kamerat e brendësisë së bankës B., është vërtetuar se i pandehuri N.D. së bashku me të pandehurin tjetër D. T. i cili mbante armën në dorë, kishin hyrë në bankë, ku nga këto incizime vërehet qartë se i pandehuri N. ofrohet tek arka e arkëtares F. me qese të najlonit në dorë dhe arkëtarja duke i vendos mjetet monetare në këtë qese dhe pasi i merr paratë i pandehuri largohet nga banka.

*Vlerësimi ligjor i veprës penale:*

Gjykata vë në vëmendje se vepra penale Grabitja nga neni 317, paragraf 3, lidhur me paragrafin 1 të KPRK-së, është parashikuar forma themelore e veprës penale e grabitjes, sipas së cilës dispozitë këtë veprë penale e kryen “Kushdo që me përdorim të forcës apo kanosjes serioze për të sulmuar jetën apo trupin e personit tjetër, e përvetëson pasurinë e luajtshme të personit të

*tillë, me qëllim që t'i sjellë vetes apo personit tjetër dobi pasurore të kundërligjshme, dënohet me gjobë dhe me burgim prej tre (3) deri në dymbëdhjetë (12) vjet.”. Ndërsa në paragrafin 3 të këtij nenit thuhet se “Nëse vepra penale nga paragrafi 1. i këtij neni kryhet nga kryesi i cili vepron si anëtar i grupit ose i cili ka me vete armën apo mjetin e rrezikshëm, kryesi dënohet me gjobë dhe me burgim prej shtatë (7) deri në dymbëdhjetë (12) vjet”.*

Gjykata gjen se në veprimet e të pandehurve përmbushen të gjitha elementet e përgjithshme dhe të veçanta të veprës penale të Grabitjes nga neni 317, paragrafi 3, lidhur me paragrafin 1 të KPRK-së. Nga gjendja e faktike është vërtetuar se i pandehuri N. pasi që ishin takuar dhe ishin marrë vesh së bashku me të pandehurin tjetër D. kanë vepruar në bashkëkryerje, ku i pandehuri N., pasi që hyn në bankë ofrohet te njëra arkë e bankës duke kërkuar që t'ia dorëzojnë parat ne qese te najlonit, pastaj i merr parat dhe largohet nga vendi i ngjarjes, ndërsa i pandehuri D. tek arka tjetër dhe nën kërcënimin e armës të cilën e kishte poseduar ky i pandehur, kryen veprën penale të grabitjes duke i marr parat.

Gjykata, për gjatë tërë shqyrtimit gjyqësor dhe bazuar në provat e administruara në shqyrtim gjyqësor, përtej çdo dyshimi ka vërtetuar se i pandehuri është i përgjegjshëm dhe përgjegjës (fajtor) për veprën penale për të cilën akuzohet. Për këto veprime të tij, gjykata e shpalli fajtor dhe e dënoi sipas ligjit, siç edhe konstatohet në këtë aktgjykim.

#### *Dashja:*

Në veprimet e të pandehurit dhe nga gjendja dhe rrethanat faktike të vërtetuara në shqyrtimin gjyqësor, Gjykata ka vërtetuar se i pandehuri ka vepruar me dashje direkte në kryerjen e kësaj vepra penale, ngase i pandehuri duke e ditur dhe se duke qenë i vetëdijshëm për veprimet e tij ka dëshiruar kryerjen e kësaj vepre penale, sepse i njëjti hynë në bankë me qëllimin e përvetësimit të pasurisë së luajtshme nga tjetri në mënyrë të kundërligjshme për vete, duke vepruar në bashkëkryerje me të pandehurin D. T., kanë arritur që të marrin sasi të konsiderueshme të mjeteve monetare nga e dëmtuara banka BKT.

#### *Bashkëkryerja:*

Bazuar në dispozitën e nenit 31 të KPRK-së, bashkëkryerja është “Nëse dy apo më shumë persona së bashku kryejnë veprën penale duke marrë pjesë në kryerjen e veprës penale ose thelbësisht duke i kontribuar kryerjes së saj në ndonjë mënyrë tjetër, secili prej tyre është përgjegjës dhe dënohet me dënimin e paraparë për vepër penale”, në rastin konkret penal kemi dy persona të pandehurin N.D. dhe të pandehurin D. T., ku plotësohet fillimisht kushti i parë,



pra dy apo më shumë persona, pastaj që të dy të personat kanë marrë pjesë në kryerjen e veprës penale të Grabitjes, duke formësuar kështu elementin e bashkëkryerjes në këtë vepër penale, pas marrëveshjes paraprake.

Gjykata ka vlerësuar edhe mbrojtjen e të pandehurit e dhënë në shqyrtim gjyqësor, i cili kishte deklaruar se ditën kritike jemi takuar një orë më herët më të pandehurin D., në takim me D., jam ankuar për shpenzimet që ka bashkëshortja për të pasur fëmijë, pasi që disa herë ka dështuar, D. më tha: “A e kryejmë një punë të lehtë?”, Shkojmë hyjmë në bankë, me grabit”, e kështu do të shliroheshim financiarisht. Unë i kam thënë: “Unë asnjëherë nuk kam kryer këto vepra penale, as hajni e asgjë tjetër”. Pastaj, më ka thënë se e ka një armë me gaz, e cila nuk hetohet, hyjmë në bankë, i marrim paratë dhe dalim për një minutë.

Në atë rast, nën ndikim të substancave narkotike dhe alkoolit, unë jam dakorduar, e kemi blerë nga një kapele, maskë të Covidit, ai ka hyrë i pari, unë pas tij, ndjehem i turpëruar para gjykatës për këtë veprim, sapo kemi hyrë në bankë i jam ofruar sportelit të arkës, i kam zgjatë duart me qese najlonit dhe arkëtarja mi ka qit paret dhe jam dal nga banka. Rrugës, duke ikur me kanë ndal Policia dhe me kanë arrestuar në afërsi rreth 200 metra nga banka, më kanë kontrolluar dhe me kanë marrë shumën e parave që kisha marr nga banka, asgjë tjetër nuk kam pas me veti.

Gjykata ka vlerësuar mbrojtjen e të pandehurit reale, koherente dhe objektive sepse i pandehuri tregon në detale ngjarjen e ditës kritike të grabitjes në bankën B., duke deklaruar se si fillimisht është takuar me të pandehurin tjetër D. dhe dakordohen për të kryer grabitjen, ku i pandehuri i dytë D. i tregon se ka një armë me veti të cilën mund ta përdorin, pastaj që pajisen me kapela dhe maska medicinale, vazhdon duke sqaruar si kanë hyrë në bankë i kanë marrë paratë dhe në ikje tregon si është arrestuar nga Policia dhe i kanë sekuestruar paratë që kishte marrë në bankë, e që ky deklaram i të pandehurit është real, sepse është në përputhje me deklaramet e dëshmitarëve të dhëna në shqyrtim gjyqësor ku dëshmitaret kanë deklaruar se i pandehuri N. ishte njëri nga personat që kishin grabitur dhe se i njëjti nuk ka pas armë dhe me provat materiale si nga raporti i këqyrjes së vendit të ngjarjes ku janë fotografuar dhe evidentuar dëshmitë si maskat medicinale dhe kapelat, siç deklaroi edhe i pandehuri që i kanë përdorur si mbulesë për t’u mos u identifikuar. Nga vërtetimi mbi sekuestrimin e përkohshëm të sendeve, ku nga i pandehuri pas arrestimit i janë sekuestruar mjetet që kishte marrë në bankë, si dhe nga prova materiale video incizimet CD shihet çartë ngjarja që ishin dy të pandehurit, i pandehuri D. me armë në dorë dhe i pandehuri N. me qese duke u ofruar tek arka e bankës.

*Vlerësimi i mbrojtjes:*

Lidhur me pretendimet e mbrojtëses av. Elena Dragusha, duke kërkuar që për veprën penale Grabitje nga neni 317, paragrafi 3 lidhur me paragrafin 1, e lidhur me nenin 31 të KPRK-së të bëhet rikualifikimi, ashtu që të hiqet paragrafi 3 dhe të mbetet paragrafi 1 i këtij neni, ngase konsideron se i mbrojturi saj nuk ka pasur armë. Gjykata, një pretendim te tillë e merr si te pa bazuar për faktin se në bazë të gjendjes faktike rezulton se vepra penale është kryer ne bashkëkryerje, ashtu që ne mënyrë paraprake, sipas marrëveshjes i pandehuri N.D. me bashkë kryesin D.T., gjerë sa ishin duke pirë kafe ishim merr vesh për mënyrën e kryerjes se veprës grabitjes ne bankën “B.”, ashtu që i bashkëpandehuri D.T. e kishte njoftuar te pandehurin N. se e posedon revolen me veti me qëllim te grabitjes. Gjykata rikujton se paragrafi 3 i nenit 317 parasheh se nëse vepra penale kryhet nga kryerësi si anëtar i grupit ose i cili ka me vete arme apo mjetin e rrezikshëm, kryesi dënohet me gjobë dhe me burgim. Andaj nga kjo rrjedh se bashkë kryesi i te pandehurit ka poseduar arme me veti me rastin e kryerjes se veprës penale dhe se vepra penale është kryer ne bashkëkryerje.

Gjykata, nga gjendja faktike dhe nga administrimi i provave ka vërtetuar se personi i cili kishte kryer veprën penale në bashkëkryerje të Grabitjes ne bankën “B.”, me datë 01.09.2023 ishte i pandehuri N.D. pasi që kishin marrëveshje paraprake që së bashku më të pandehurin D. T., qe posedonte armen e qe nën kërcënimin e armës, kanë kryer veprën penale të grabitjes në bankën B.

Gjykata ka vërtetuar nga provat e administruara se i pandehuri N.D. nuk ka pas armë në ditën kritike të kryerjes së veprës penale, por kishte pas armë i pandehuri D. T., andaj Gjykata nuk mund të bëjë ri cilësimin e veprës penale sipas paragrafit 1 te nenit 317 të KPRK-së siç ka propozuar mbrojtja mbi bazën e asaj që i mbrojturi i saj nuk ka pas armë, por për këtë vepër penale sipas kualifikimit ligjor plotësohet elementi i veprës penale i prezencës së armës në këtë rast nga i pandehuri i dytë.

Prandaj, si përfundim Gjykata, nga provat e administruara në shqyrtimin gjyqësor ka vërtetuar përtej çdo dyshimi se i akuzuari ka kryer veprën penale: Grabitje nga neni 317 par 1 lidhur me paragrafin 3 dhe nenin 31 të KPRK-së.

*Matja e llojit dhe lartësisë së dënimit:*

Gjykata lidhur me caktimin e llojit dhe lartësisë së dënimit për të pandehurin ka vlerësuar rrethanat për matjen e dënimit në mbështetje të nenit 69 të KPRK-së, e si rrethanë rënduese gjykata ka vlerësuar kontributin esencial në këtë vepër penale, mënyrën e kryerjes se veprës

penale, ngase i njëjti është përgatitur paraprakisht për kryerjen e veprës penale, pesha dhe pasoja e shkaktuar me këtë vepër penale, nga evidenca e te kaluarës kriminale rezulton se i pandehuri me parë është i dënuar me aktgjykim me numër P. nr.86/2015, i plotfuqishëm me datën 09.03.2016 për veprën penale blerje posedim shpërndarje dhe shitje e paautorizuar e narkotikëve, substancave psikotrope dhe analoge. Si rrethana lehtësuese, Gjykata e ka marr parasysh dhe vlerësuar si të tilla: i pandehuri është mbajtës i familjes, se i pandehuri në kohën kur e ka kryer këtë vepër penale ka qenë i moshës relativisht të re, shprehjen e pendimit dhe keqardhjes për kryerjen e veprës penale, pasi që i njëjti i kishte pranuar veprimet ne raport me veprën penale mirëpo kualifikimin ligjor jo, rrethanat e tij personale, nga se i njëjti jeton vetëm me nenën e bashkëshorten e që nuk ka se kush të kujdeset për to.

Gjykata, për te pandehurin, sa i përket dënimit me burgim, në kuptim të nenit 71 të KPRK-së ka aplikuar dispozitat e zbutjes së dënimit, duke u bazuar në faktin se i pandehuri i ka pranuar veprimet e tij ne raport me veprën penale Grabitje, duke mos e pranuar kualifikimin ligjor, dhe pavarësisht se nuk kemi të bëjmë me institutin e pranimit të fajësisë, prapë se prapë, për Gjykatën ky pranim duhet të vlerësohet në një mënyrë si pranim i fajit, ngase për më tepër Gjykata për këto veprime që i ka pranuar edhe e ka shpallur fajtor. Andaj, duke i pasur parasysh këto rrethana lehtësuese gjykata vendosi për zbutjen e dënimit, respektivisht që gjykata të shqiptojë dënim nën minimumin e dënimit të paraparë për këtë vepër. Megjithatë, me rastin e zbutjes së dënimit, janë respektuar kufijtë e zbutjes sipas nenit 72, par.1, nën par. 1.2 të KPRK-së, që në rastet e tilla, kur minimumi i dënimit për veprën penale është 7 vjet, dënimi mund të zbutet deri në 3 vjet, çka në rastin konkret Gjykata ka shqiptuar dënim me burgim prej (5) vite.

Gjykata, pasi i ka peshuar mirë dhe drejtë rrethanat lehtësuese dhe ato rënduese, duke e vlerësuar secilën prej tyre, ka ardhur në përfundim që të akuzuarit t'i shqiptoj dënim si në dispozitiv të këtij Aktgjykimi.

Gjykata vlerëson se dënimi i shqiptuar në rastin konkret është i drejtë dhe i ligjshëm, në harmoni me shkallën e përgjegjësisë penale të të akuzuarit, shkallën e rrezikshmërisë së veprës penale dhe me intensitetin e rrezikimit apo dëmit që i është shkaktuar vlerës së mbrojtur nga kryerja e kësaj vepre penale. Po ashtu, gjykata vlerëson se një dënim i tillë do të ndikojë në parandalimin e të akuzuarit nga kryerja e veprave penale në të ardhmen si dhe në rehabilitimin e tij, në parandalimin e personave tjerë nga kryerja e veprave penale, në kompensimin e palës së dëmtuar për humbjet ose dëmet e shkaktuara nga vepra penale si dhe në shprehjen e gjykimit

shoqëror në raport me veprën penale, ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit në shoqëri, duke ndikuar në këtë mënyrë në përmbushjen e qëllimit të dënimit, të paraparë në nenin 38 të KPRK-së.

*Llogaritja e paraburgimit:*

Vendimi mbi llogaritjen e kohës së qëndrimit në paraburgim të pandehurit u mor në pajtim me nenin 79 të KPRK-së, ashtu që të pandehurit koha e kaluar në paraburgim nga data 01.09.2023 do ti llogaritet në dënimin me burgim të caktuar sipas këtij aktgjykimi.

*Vazhdimi i paraburgimit:*

Vendimin për vazhdimin e paraburgimit pas shpalljes së aktgjykimit, Gjykata e ka bazuar në nenin 366 par.1 pika 1.1 lidhur me par 3 dhe 6 lidhur me nenin 184 par.1 nën par. 1.1 dhe 1.2 pika 1.2.1 dhe 1.2.3 të KPPRK-së, Gjykata ka vazhduar masën e paraburgimit ndaj të pandehurit, duke vlerësuar se është vërtetuar dyshimin e bazuar, po ashtu ende qëndrojnë kushtet e veçanta ligjore sepse pasi që të pandehurit i është caktuar dënimi me burgim, ka rrezik të ikës ashtu që të mund ti shmanget ekzekutimit të dënimit me burgim dhe se mënyra e kryerjes së kësaj vepre penale dhe rrezikshmëria e lart kanë treguar se i pandehuri do të mund të përsërisë në të ardhmen veprën penale të ngjashme.

*Vlerësimi i Gjykatës për pikën II, vepra penale: Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve, nga neni 366, par.1 të KPRK-së:*

Sipas pikës II të aktakuzës, i pandehuri është akuzuar për veprën penale: Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve, nga neni 366, par.1 të KPRK-së.

Lidhur me dispozitiv II të këtij aktgjykimi, Gjykata ka liruar nga akuza të pandehurin N.D. për veprën penale Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 366 paragrafi 1 të KPRK-së, ngase Gjykata ka vërtetuar përtej dyshimit të bazuar mirë se i pandehuri, në ditën kritike me rastin e kryerjes së veprës penale Grabitje nuk posedonte arme me veti e po ashtu edhe me rastin e arrestimit nga policia e Kosovës menjëherë pas kryerjes së veprës penale të grabitjen nuk ka poseduar armen. këtë fakt Gjykata e ka provuar me provat personale të dëshmitarëve, ku dëshmitarja F. ka deklaruar se ka ardhur i pandehuri N.D. para meje, me qese në dorë dhe ka bërtit me një zë shumë të lartë: “Qiti paratë” kam vepruar ashtu siç më ka thënë grabitësi dhe në atë rast ia kam gjuajtur paratë në qese dhe i njëjti ka dal jashtë.

I pandehuri N.D., ditën kritike nuk ka pasur armë, ka pasur maskë mjekësore, ngjyrë të kaltër të qelët, maskë mbrojtëse nga Covidi, i ka marr paratë dhe ka ikur. nga dëshmia e dëshmitares M. J. vërtetohet se i pandehuri N. nuk ka pasur armë sepse pas kryerjes se veprës të njëjtin e ka ndjek prapa dhe kur i pandehuri arrestohet nga Policia, pas kontrollës ndaj tij nuk i kanë gjetur armë por vetëm mjetet monetare, dëshmitarja ishte në afërsi rreth 1 metër larg nga i pandehuri në atë momente, po edhe nga dëshmia e dëshmitarit A. R., vërtetohet se i pandehuri N. nuk ka pas armë por ishte i pandehuri D. i cili ishte i pari që ishte futur në bankë dhe ka repetitur armën duke bërë titur “grabitje”, e këtë fakt e vërteton nga konstrukti trupor i të pandehurve ku i pandehuri D. është me i gjatë dhe i dobët se i pandehuri N., po ashtu edhe dëshmitarja Sh. S. deklaroi se i pandehuri D. ishte personi që kishte pas armë atë ditë sepse i njëjtë shkon tek arka e arkëtares V. Q. për të grabitur ndërsa i pandehur N. ishte ofruar tek arka e arkëtares F., dëshmia e dëshmitares V. Q. vërteton çart se i pandehuri N. nuk kishte pas armë por i pandehuri D. sepse i pandehuri D. ishte personi i cili ishte ofruar tek arka ku ishte duke punuar dëshmitarja ku i pandehuri D. i drejtohet me fjalë duke bërë titur “Shpejtë, qitni paratë, të trasha, të trasha”, dhe gjatë kohës sa m’i ka marr paratë, armën e ka pasur të drejtuar nga unë .

Gjykata si me lart dëshmitë e dëshmitarëve i ka pranuar se dëshmi të bazuara, reale dhe objektive dhe ne lidhshmëri me provën materiale video incizimeve të CD-së ku nga këto incizime që janë brenda bankës B., vërehet çart se i pandehuri N. nuk kishte pasur armë por ishte i pandehuri D. ai i cili kishte pas armën dhe të njëjtën e kishte ekspozuar dhe drejtuar në personelin e bankës me rastin e grabitjes, prova të cilave ju ka falur besimin si prova relevante për çështjen penale, ka vërtetuar se i pandehuri N.D. nuk ka kryer veprën penale Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 366 paragrafi 1 të KPRK-së. Gjykata i vlerësoi edhe pretendimet e mbrojtjes ne raport me te pandehurin, duke theksuar se nuk ka prova se i pandehuri e ka kryer veprën penale Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 366, paragrafi 1 të KPRK-së, se i propozon gjykatës qe të merr aktgjykim lirues. Gjykata një pretendim te tille e konsideron si te bazuar nga se me asnjë prove te cekur si me lare nuk vërtetohet fakti se i pandehuri e ka kryer këtë vepër penale.

#### *Shpenzimet e procedurës penale:*

Gjykata ka vendosur që i pandehuri të obligohet që të paguajë shpenzimet e procedurës penale deri në lartësinë e shpenzimeve të shkaktuara të procedurës penale. Vendimin për shpenzimet e procedurës, gjykata e ka marrë në bazë të nenit 449 par. 2 pika 2.1 dhe 2.6 dhe nenit 452 par.1

të KPPRK-së. Ndërsa taksa për kompensimin viktimave të krimit, në kuptim të nenit 39 par. 3 të Ligjit nr. 05/L-036 për Kompensimin e Viktimave të Krimit.

*Kërkesën pasurore juridike:*

Vendimi mbi udhëzimin e palës së dëmtuara për realizimin e kërkesës pasurore-juridike në kontest të rregullt civil është marrë pasi që pala e dëmtuara edhe pse kishte precizuar kërkesën pasurore juridike dhe se ka bashkangjitur prova lidhur me këtë dëm material, Gjykata nuk mund të gjykojë kërkesën pasurore juridik përtej asaj që nga i pandehuri janë konfiskuar dhe kthyer palës së dëmtuar shumën e mjeteve të grabitura, andaj për pjesën tjetër të dëmit material është udhëzuar ta realizon në kontest të rregullt civilo-juridik, konform nenit 462 par.2 të KPPRK-së. Pra nga ky i pandehur është kthyer shuma e parave e cila është grabitur që ishte 5,810.00 euro.

Gjykata, nga arsyet e cekura si më lartë e bazuar në nenin 364 të KPPRK-së, vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykim.

**GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË**

**Departamenti për Krime të Rënda**

**PKR.nr.350/2023, datë: 04.06.2024**

Bashkëpunëtori profesional  
Albrim Kastrati

Kryetari i trupit gjykues-gjyqtari  
**Gëzim ADEMI**

**KËSHILLË JURIDIKE:** Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar e drejta në ankesë në afat prej 30 ditësh, nga dita e pranimit të aktgjykimit. Ankesa, i drejtohet gjykatës së Apelit në Prishtinë, nëpërmjet kësaj gjykate në kopje të mjaftueshme.